



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSË STUDIMI NË SEMINARET E GJUHËS,  
LETËRSISË DHE KULTURËS BULLGARE  
TË ORGANIZUARA NGA UNIVERSITETI I SOFJES “SHËN KLIMENT I OHRIT”  
DHE UNIVERSITETI I QYTETIT VELIKO TARNOVO “SHENJTORËT KIRIL DHE  
METODIJ”**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Bullgarisë na informon mbi edicionin e sivjetshëm të seminareve të gjuhës, letërsisë dhe kulturës bullgare të organizuara nga Universiteti i Sofjes “Shën Kliment i Ohrit” dhe Universiteti i qytetit Veliko Tarnovo “Shenjtorët Kiril dhe Metodij”.

Për studentët dhe shkencëtarët nga Shqipëria janë parashikuar 3 (tre) vende, konkretisht:

- për seminarin e organizuar nga Universiteti i Sofjes “Shën Kliment i Ohrit”, gjatë periudhës 15.07.2024 - 04.08.2024, është parashikuar 1 (një) vend;
- për seminarin e organizuar nga Universiteti i qytetit Veliko Tarnovo “Shenjtorët Kiril dhe Metodij”, gjatë periudhës 14.07.2027 - 03.08.2024, janë parashikuar 2 (dy) vende.

Pala bullgare i siguron pjesëmarrësve ushqim, akomodim dhe programin arsimor dhe kulturor. Shpenzimet e transportit deri në vendin e seminarit dhe anasjelltas, si dhe sigurimi shëndetësor duhet të mbulohen nga pjesëmarrësit.

Bëhemi me dije se gjatë miratimit të kandidateve të propozuara, përparësi do të kenë aplikantët, të cilët studiojnë gjuhën bullgare pranë Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë aplikimet e tyre sipas formularëve [bashkëlidhur](#) pranë Minsitrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë brenda datës **1 prill 2024**.

Për më shumë informacion lutem të vizitoni webfaqet e universiteteve në links të mëposhtëm:

<https://www.slav.uni-sofia.bg/index.php/summer-seminar>

<https://www.uni-vt.bg/bul/?zid=144>

**SUKSESE!**